



Datë: 21.02.2025

Numër protokoli: 2041/2025

A.nr.30/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.30/2025, të datës 08.01.2025, të parashtruar nga ankuesit B.M, M.Z., B.K., F.Sh., B.B., J.M., I.Sh, J.M., L.B., S.B., B.H., Xh.M., R.Sh., A.K., P.G., R.B., E.M., A.K., K.S., L.K., J.Sh., R.H., V.M., A.M., R.G., M.K., H.H., Xh.B., M.K., A.D., A.Z., H.K., E.G., M.P, M.M., E.K., A.P., M.K., S.M., N.M., M.K., R.P., A.P., A.B., S.K., A.M., R.G., Xh.B., B.B., D.K., A..H., E.K., K.K., M..S., Q.G., G.B., Q.M., Xh.H, Xh.K., S.Z., V.Z., A.K., F.B. dhe E.G., të cilët me autorizim i përfaqëson Avokat Esat Sylja nga Skenderaj, kundër organit të punësimit Komuna e Malishevës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 dhe 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim më datë 21.02.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Hedhet poshtë si e parakohshme** ankesa me numër A.nr.30/2025, e datës 08.01.2025 e ankuesve B.M, M.Z., B.K., F.Sh., B.B., J.M., I.Sh, J.M., L.B., S.B., B.H., Xh.M., R.Sh., A.K., P.G., R.B., E.M., A.K., K.S., L.K., J.Sh., R.H., V.M., A.M., R.G., M.K., H.H., Xh.B., M.K., A.D., A.Z., H.K., E.G., M.P, M.M., E.K., A.P., M.K., S.M., N.M., M.K., R.P., A.P., A.B., S.K., A.M., R.G., Xh.B., B.B., D.K., A..H., E.K., K.K., M..S., Q.G., G.B., Q.M., Xh.H, Xh.K., S.Z., V.Z., A.K., F.B. dhe E.G.

**II.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.30/2025, të datës 08.01.2025, të parashtruar nga ankuesit B.H., Xh.M., R.Sh, A.Z., J.M., B.B., R.G. dhe Xh.B.

**III.** Lënda lidhur më ankuesit si pikën II të dispozitivit, bartet për shqyrtim dhe vendosje të Komisioni për Ankesa, në Komunën e Malishevës.

### **A r s y e t i m**

Ankuesit përmes përfaqësuesit të tyre Avokat Esat Syla, dhe atë përmes postës, më datë 01.01.2025, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 08.01.2025 dhe regjistruar nën shenjen A.nr.30/2025, duke kërkuar që Këshilli t'iu njohë shtesën në pagë prej 0.5%, dhe atë në mënyrë retroaktive nga data 06.02.2023 e tutje, shtesat e SHCK në pagë në shumë prej 31.20 euro për muaj, dhe atë në mënyrë retroaktive nga data 06.02.2023 e tutje dhe shujtat në vlerë prej 4 euro për secilën ditë të pranisë në punës dhe atë nga vitit 2021 e deri në tani, duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë Nr. 08/48 të datës 09.09.2015.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.01.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Shtimes, ndërsa, kjo e fundit, më datë 30.01.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë.

***Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:*** Ankesën me numër protokollit 53/2025 të datës 08.01.2025, e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Vërtetim mbi pranimin e dërgesës i datës 11.11.2024; Mendimin Juridik të datës 09.10.2023 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës; Vendimin me Nr. 08/48 të datës 09.09.2015 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Zarfën e datës 01.01.2025; Autorizimet për përfaqësim; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 23.01.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 30.01.2025; Akt Emërimin me Nr. 01/241 të datës 27.01.2012 për ankuesin B.B; Akt Emërimin me Nr. 01/711 të datës 16.07.2020 të ankuesin A.B; Akt Emërimin Nr.01/214 të datës 25.01.2012 të ankuesit Xh.B; Akt Emërimin me Nr. 01/49 të datës 04.01.2012 të ankuesit R.G; Akt Emërimin Nr. 01.212 të datës 25.01.2012 të ankuesit A.M; Akt Emërimin Nr.01/210 të datës 25.01.2012 të ankuesit S.K Akt Emërimin Nr. 01/178 të datës 24.01.2012 të ankuesit D.K; Akt Emërimin me Nr. 01/96 të datës 11.01.2012 të ankuesit A.P; Akt Emërimin me Nr. 01/830 të datës 06.06.2015 të ankuesit M.K; Akt Emërimin me Nr. 01/32 të datës 04.01.2012 të ankueses E.U, Akt Emërimin me Nr. 01/1246 të datës 14.09.2023

të ankuesit F.B; Akt Emërimin me Nr.01/59 të datës 11.01.2012 të ankueses V.K; Akt Emërimin me Nr. 01/192 të datës 24.01.2012 të ankueses S.Z; Akt Emërimin me Nr. 01/183 të datës 24.01.2012 të ankuesit Xh.K; Akt Emërimin me Nr. 01/779 të datës 02.06.2023 të ankueses Xh. H; Akt Emërimin me Nr. 01.266 të datës 05.03.2024 të ankuesit Q.M; Akt Emërimin me Nr. 01/60 të datës 11.01.2012 të ankuesit G.B; Akt Emërimin me Nr. 01/908 të datës 09.09.2013 të ankuesit M.S; Akt Emërimin me Nr. 01/187 të datës 24.01.2012 të ankuesi K.K; Akt Emërimin me Nr. 01/1163 të datës 06.12.2013 të ankueses E.K; Akt Emërimin me Nr. 01/866 të datës 02.10.2012 të ankuesit A.H; Akt Emërimin me Nr. 01/844 të datës 17.09.2021 të ankuesit A.K; Akt Emërimin me Nr. 01/229 të datës 25.01.2012 të ankuesit M.K; Akt Emërimin me Nr. 01-719 të datës 16.05.2018 të ankuesit A.M; Akt Emërimin me Nr. 01/985 të datës 02.10.2013 të ankueses V.M; Akt Emërimin me Nr. 01/1081 i datës 22.10.2020 të ankuesit R.H; Akt Emërimin me Nr. 01.176 të datës 24.01.2012 të ankuesit J.Sh; Akt Emërimin me Nr. 01/80 të datës 11.01.2012 të ankuesit M.K; Akt Emërimin me Nr. 01/607 të datës 20.04.2023 të ankuesit S.B; Akt Emërimin me Nr. 01/1129-2021 të datës 07.12.2021 të ankuesit L.B; Akt Emërimin me Nr. 01/625 të datës 26.04.2023 të ankuesit J.M; Akt Emërimin me Nr. 01/650 të datës 30.04.2018 të ankuesit I.Sh; Akt Emërimin me Nr. 01/1132 të datës 01.08.2018 të ankuesit F.Sh; Akt Emërimin me Nr. 01/852 të datës 18.06.2019 të ankuesit B.K; Akt Emërimin me Nr. 01/1233 të datës 13.09.2023 të ankuesit M.Z; Akt Emërimin me Nr. 01/65 të datës 11.01.2012 të ankuesit N.M; Akt Emërimin me Nr. 01.96 të datës 11.01.2012 të ankuesit N.A; Akt Emërimin me Nr. 01/77 të datës 11.01.2012 të ankuesit A.P; Akt Emërimin me Nr. 01/890 të datës 08.10.2012 të ankuesit E.K; Akt Emërimin me Nr. 01.58 të datës 11.01.2012 të ankuesit M.M; Akt Emërimin me Nr. 01/179 të datës 24.01.2012 të ankuesit M.P; Akt Emërimin me Nr. 01/92 të datës 04.01.2012 të ankuesit E.G; Akt Emërimin me Nr. 01/165 të datës 24.01.2012 të ankuesit H.K; Akt Emërimin me Nr. 01/1813 të datës 31.10.2022 të ankuesit L.K; Akt Emërimin me Nr. 01/943/2022 të datës 13.06.2022 të ankuesit K.S; Akt Emërimin me Nr. 01/993/2021 të datës 10.11.2021 të ankuesit A.K; Akt Emërimin me Nr. 01/791 të datës 01.07.2024 të ankuesit A.K; Akt Emërimin me Nr. 01/1536 të datës 30.11.2023 të ankuesit P.G; Akt Emërimin me Nr. 01/193 të datës 24.01.2012 të ankuesit R.B; Akt Emërimin me Nr. 01/81 të datës 11.01.2012 të ankueses A.D; Akt Emërimin me Nr. 01/174 të datës 24.01.2012 të ankuesit M.K; Akt Emërimin me Nr. 01/167 të datës 24.01.2012 të ankueses S.M; Akt Emërimin me Nr. 01/1397 të datës 23.12.2020 të ankuesit B.M; Akt Emërimin me Nr. 01/168 të datës 24.01.2012 të ankuesit H.H; Akt Emërimin me Nr. 01/832 të datës 06.06.2015 të ankuesit Q.G; Akt Emërimin me Nr. 01/990 të datës 07.07.2015 të ankuesit R.P; Akt Emërimin me Nr. 01/677 të datës 10.07.2012 të ankuesit E.M deh Aktvendimin e datës 06.01.2015; Kontratë Pune me Nr. 01/423 të datës 08.04.2019 të ankuesit B.H; Akt Emërimin me Nr. 01/89 të datës 11.01.2012 të ankuesit Xh.M; Akt Emërimin me Nr. 01/863 të datës 18.07.2024 të ankuesit R.Sh; Akt Emërimin me Nr. 01/964 të datës 06.11.2012 të ankuesit A.Z; Kontratë Pune me Nr. 01/1204 të datës 09.10.2017 të ankuesit J.M; Akt Emërimin me Nr. 01/374 të datës 01.04.2015 të ankuesit B.B, Aktvendimin e datës 19.01.2024 për B.B dhe Akt Emërimin me Nr. 01/962 të datës 06.11.2022 të ankuesit R.G; Kërkesën e datës 10.10.2024 të ankuesve; Përgjigjen në kërkesë e datës 10.02.2025 nga G.B për A.B; Përgjigjen

në kërkesë e datës 12.02.2025 nga G.B për A.B; Kërkesën e datës 12.12.2024 të ankuesve dhe Përgjigjen me numër protokollit 01/1148 të datës 04.11.2024, përmes Avokatit Publikë të Komunës.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se rastin e ankuesve si në pikën I të dispozitivit, është e parakohshme, **sepse:**

Nga shqyrtimi i provave të administruara rrjedhë së ankuesit si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimit, kanë statusin e nëpunësit të shërbimit civil, andaj mbi këtë bazë, Këshill në kuptim të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka kompetencë lëndore që të shqyrtoj ankesën e tyre.

Rrjedhimisht, sipas provave të administruara del së ankuesit përmes Avokat Esat Sylja, më datë 10.10.2024, kanë parashtruar kërkesë tek Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Malishevës, për kompensimin e shujtat për ditët e pranisë në punë për secilin zyrtar të kësaj komunës duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë së Kosovës si fakt notor; Shtesat në pagës për secilin nëpunës të kësaj komunë prej 0.5% për vitet e përvojës në punës nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë; Shtesat-SHCK në pagë nga 31.20 euro në muaj për secilin nëpunës, ashtu siç i kanë realizuar para hyrjes në fuqi të Ligjit të Pagave Nr. 08/L-196.

Komuna e Malishevës gjegjësisht Zyra e Kryetarit të Komunës përmes Avokatit Publik të Komunës më datë 04.11.2024, përmes përgjigjes në kërkesë me numër protokollit 01/1148, ka refuzuar kërkesën e palëve duke i njoftuar që kërkesat e tilla duhet të kalojnë përmes Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Tutje, sipas shkresave të lëndës rrjedhë së ankuesit përmes Avokat Esat Sylja, serish më datë 12.12.2024, kanë parashtruar kërkesë pranë organit të punësimit mbi pretendimet sikurse në kërkesën e datës 10.10.2024, kurse, në përgjigjen në ankesë të datës 12.02.2025, Komuna e Malishevës deklarojnë së nuk janë përgjigjur në kërkesën e ankuesve të datës 12.12.2024, pasi që për kërkesën e njëjtë janë përgjigjur me datë 04.11.2024.

Ankuesit më datë 08.01.2025, parashtrojnë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet së pas kërkesave të përsëritura, nuk kemi pranuar përgjigje nga Komuna e Malishevës, duke kërkuar që Këshilli të aprovoj ankesën e tyre dhe të obligoj Komunën e Malishevës që të njohë ankuesve kompensimin e shtesës në pagë prej 0.5% nga data 06.02.2023 e tutje, shtesës SHCK në pagë 31.20 euro në muaj për secilin nëpunës nga data 06.02.2023 e tutje ashtu siç e kanë realizuar para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për

Pagat në Sektorin Publikë, dhe shujtat nga 4 euro për secilën ditë të pranisë në punës nga vitit 2021 e deri në tani duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë me Nr. 08/48 të datës 09.09.2015.

Kolegji i Këshillit në kuptim të pranushmerisë së ankesës së ankuesve sikurse në pikën I të dispozitivit iu referua Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, më konkret nenit 98 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj, si dhe nenit 127 paragrafi 1 dhe 4 i të njëjtët ligj ku përcaktohet se: “1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ..”* e në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji konstaton se ankesa e ankuesve si në pikën I të dispozitivit e parashtruar në Këshill më datë 08.01.2025 është e paraafatshme, pasi që ankuesit ende pa kaluar afati ligjor për përfundimin e procedurës administrative të iniciuar sipas kërkesës së datës 12.12.2024 dhe rrjedhimisht ende pa u përmbushur kriteri kohor lidhur me heshtjen administrative parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Andaj, mbi këtë bazë konstatimi, Kolegji vlerëson se ankesa e ankuesve si në pikën I të dispozitivit është pa pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu qw bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit si në pikën II të dispozitivit, **sepse:**

Nga provat e lëndës Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi B.H sipas Kontratës së Punës me Nr.01/423 të datës 08.04.2019, është i punësuar në pozitën *Vozitës*, ankuesi Xh.M sipas Akt Emërimit me Nr. 01/89 të datës 11.01.2012, është i punësuar në pozitën *Përgjegjës i Shërbimit Teknik-Vozitësve*, ankuesi R.Sh, sipas Akt Emërimit me Nr. 02.863 të datës 18.07.2024, është i punësuar në pozitën *Vozitës*, ankuesi A.Z sipas Akt Emërimit me Nr. 01/964 të datës 06.11.2012, është i punësuar në pozitë *Roje e Sigurisë së Objektivit*, ankuesi J.M, sipas Kontratës së Punës me Nr. 01/1204 të datës 09.10.2017, është i punësuar në pozitën *Roje e Sigurisë së Objektivit*, ankuesi B.B sipas Aktvendimit me Nr. 01/16 të datës 09.01.2024, është i punësuar në pozitën *Roje e Sigurisë*, ankuesi R.G sipas Akt Emërimit me Nr. 01/962 të datës 06.11.2012, është i punësuar në pozitën *Roje e Sigurisë së Objektivit*, dhe ankuesi Xh.B sipas Akt Emërimit me Nr. 01/892 të

datës 08.10.2012, është i punësuar në pozitën *Roje e Sigurisë së Objektivit*, të gjithë të punësuar në Komunën e Malishevës.

Kolegji i Këshillit në kuptim të kompetencës lëndore iu referua nenit 5 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrat e Publikë, ku përcakton se: *Kategoritë e zyrtarëve publikë janë: 1.1. Nëpunësja/i i shërbimit civil; 1.2. Nëpunësja/i i shërbimit publik; 1.3. Krijuesja/i dhe performuesja/i e/i artist dhe kulturës; 1.4. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës; dhe 1.5. Zyrtarja/i i kabinetit... 2. Nëpunësja/i i shërbimit civil është zyrtarja/i publik në kuadër të shërbimit civil i cili merr pjesë në formulimin dhe/apo zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme profesionale dhe administrative në zbatim. Nëpunësja/i i shërbimit civil ushtron detyrën në pozitën përkatëse, duke filluar nga zyrtarja/i profesional deri në pozitën e drejtueses/it të lartë, në administratën e Presidentes/it të Republikës së Kosovës, në administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në Zyrën e Kryeministres/it të Republikës së Kosovës, në Ministri, në Agjenci Ekzekutive dhe në degë lokale të tyre, institucione të pavarura kushtetuese, në agjenci të pavarura dhe rregullatore, në administratën komunale dhe çdo nëpunës/ës statusi i të cilit është përcaktuar si nëpunës/ës i shërbimit civil, me ligj të veçantë. .... 5. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës është zyrtarja/i publik që kryen veprimtari ndihmëse të mirëmbajtjes, të ruajtjes, të vozitjes dhe veprimtari të ngjashme në institucionet publike”*,

Andaj, referuar përcaktimi ligjor si më sipër, rrjedhë së ankuesit si në pikën II të dispozitivit nuk kanë statusin e nëpunësit civil, gjegjësisht pozita roje e sigurisë dhe vozitës janë pozita të nëpunësit administrativ dhe mbështetës, kështu që mbi këtë bazë, Kolegji duke u bazuar në nenin 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi që të shpallë veten jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën të parashtruar nga ankuesit si në pikën II të dispozitivit.

Lidhur më të drejtën e ankuesit në mjete juridike si e drejtë kushtetuese garantuar më Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejta e Njeriut (neni 13), Kolegji i Këshillit ve në dukje përcaktimet ligjore sipas nenit 95 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrat e Publikë, ku përshihet se: Neni 95, paragrafi 1: *1. Punëdhënës në marrëdhënien e punës të nëpunës/it teknik dhe mbështetës është institucioni përkatës, përmes udhëheqëses/it më të lartë administrativ të institucionit. 2. Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të ligjit, marrëdhënia e punës ndërmjet institucionit dhe nëpunës/it teknik dhe mbështetës rregullohet me legjislacionin e punës. E në ndërlidhje me këtë Ligji Nr. 03/L-212 i Punës përkatësisht me nenin 78 dhe 79 ka përcaktuar: Neni 78, paragrafi 1” 1. I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë të punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. 2. Punëdhënësi*

*është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës. Neni 79 paragrafi 1: Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.*

Marr parasysh konstatimin si me lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesve si në pikën II të dispozitivit, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se ankuesit nuk kanë parashtruar ankesë të brendshme pranë organit të punësimit, atëherë, bazuar në nenin 75 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa të Komunës së Malishevës.

Theksuar si më sipër, e duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafët 1.7 dhe 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Këshillë juridike:*** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

## **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

*Lënda me numër A.nr.30/2025*

**Avdyl BEKTESHI**

Procesmbajtës

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

Kryetare e Kolegjit

### **Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të ankuesve Avokat Esat Sylja;
- Organit të punësimit: Komisionit të Ankesave dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Malishevës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.